



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

KF.nr.291/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli, dhe me zyrtarin ligjor Albert Haliti në kontestin tregtar administrativ të paditësit Sh.K B.I, me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson K.B, avokat në Prishtinë, Rr. "...", nr. ..., kundër të paditurit Dogana e Kosovës në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimit, objekt kontesti - rivlerësim malli, vlera e kontestit 1,679.17 €, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të datës 07.04.2023, të mbajtur në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, avokat K.B, dhe përfaqësuesit të autorizuar të padituri, M.K, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit Sh.K B.I, me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson K.B, avokat në Prishtinë, si e pa bazuar.
- II. MBETËT NË FUQI Aktvendimi nr.01.3.2.2/16911 i datës 02.11.2021, i Doganës së Kosovës në Prishtinë.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 07.12.2021, ka iniciuar kontestin tregtar administrativ kundër të paditurit Dogana e Kosovës, me të cilën ka kërkuar anulimin e aktvendimit nr.01.3.2.2/16911 i datës 02.11.2021, për shkak të shkeljes së dispozitave të Kodit Doganor dhe Akcizave, shkeljes së dispozitave ligjore të UA 11/2009 për

implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe shkeljes së parimeve dhe rregullave të procedurës administrative. Ndërsa në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i autorizuar i paditësit ka deklaruar se mbes në tërësi si në të theksuarat në padi duke konsideruar se e paditura me anë të aktvendimit të atakuar ka bërë shkeljet ligjore të referuara në padi, përkatësisht nenit 33 të KDA-së lidhur me nenin 123 të OA 11/2009, pasi që paditësi DUD-ave kontestues i'u ka bashkangjitur dokumente relevante për të vërtetuar çmimin e paguar në emër të automjeteve të deklaruara për doganim, përkatësisht faturat, pagesat bankare në emër të veturave më të cilat janë evidentuar numrat e karrocive të veturave të paguara si dhe deklaratën eksportuese nga shteti eksportues, të gjitha këto të harmonizuara në kuptim të vlerës. E paditura konsiderojmë se ka vërtetuar në mënyrë të gabuar gjendjen faktike sepse konsiderojmë se nuk i ka vlerësuar automjetet në mënyrë objektive duke qenë se të njëjtat kanë qenë të aksidentuara ose me defekte siç mund të shihet edhe nga fotot e dokumentacionit nga shkresat e lëndës, prandaj konsiderojmë se dokumentet e tyre kanë pasqyruar vlerën reale. Me qëllim të vërtetimit të pretendimeve nga kërkesë padia, gjykatës në këtë seancë në kopje të mjaftueshme edhe për palën e paditur i dorëzoi dokumentet me të cilat vërtetohet se në favor të paditësit është zgjidhur një lëndë e njëjtë lidhur me automjetet e importuara nga eksportuesi i njëjtë përkatësisht aktvendimin nr:2789/13.02.2023 , 1590/27.01.2023 të dt:21.02.2023 të lëshuar nga e paditura. DUD-at nr 7475,7476, 7477, dhe 7478, të gjitha të dt :05.04.2017 me faturat dhe pagesat bankare përkatëse. Duke marrë për bazë të theksuarat dhe provat e administruara , i propozoj gjykatës të aprovoj kërkesë padinë e paditësit në tërësi të bazuar ashtu që të anuloi aktvendimin e atakuar dhe të detyroj të paditurën ti kthej paditësit mjetet e paguara më tepër në emër të detyrimeve doganore për shkak të rivlerësimit në shumë prej 1,679.17 Euro me kamatë në shkallë prej 8% nga dt: 07.08.2021 e deri në kthimin e plotë. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

E paditura, në përgjigje në padinë e datës 23.02.2023 e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, duke theksuar se aktvendimi i atakuar është marrë konform të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare, me arsyetimin se vendimi i atakuar është

marrë konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme. Andaj, i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj në tërësi si të pa-bazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit dhe ta lë në fuqi aktvendimin kontestues si të ligjshëm. Ndërsa në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës ka deklaruar se pretendimet e paditësit se ky vendim është marrë në mënyrë të kundërligjshme nuk qëndrojnë dhe nuk mbështeten në asnjë provë të vetme. Gjatë rishqyrtimit të ankesës të paditësit sektori i rishqyrtimeve në doganë ka sqaruar se Dogana e Kosovës gjatë fazës së pranimit dhe shikimit të mallit ka marrë për bazë metodën 6 të vlerësimit të mallit apo nenit 35 të KDA-së, për arsye se pala ka paraqitur vlera shumë të ultë dhe dogana ka marrë për bazë katalogun schwacke e cila paraqet vlerën reale të tregut të automjeteve dhe gjithashtu duke parë gjendjen reale të mallit i cili ka qenë me dëmtime ka krijuar komisione profesionale duke nxjerrë raportin e vlerësimit mbi vlerën e mallit të dëmtuar dhe ka konstatuar se të tria automjeteve janë të dëmtuara në vlerën prej 25 deri 35% dhe ka arritur te çmimi real i mallit. Gjithashtu pala në fazën e deklarimit të mallit nuk ka bashkangjitur dokumente të kompletuara pasi që në rastin konkret ka qenë e domosdoshme me kontratë me të cilin do specifikoheshin edhe dëmtimet reale të automjeteve. Sa i përket provave të dorëzuara në këtë seancë konsiderojmë se mund të ketë ngjashmëri por, për doganën secili rast trajtohet ndaras dhe ka specifikat e veta dalluese. Bazuar në thëniet e cekura, propozoj gjykatës të nxjerr aktgjykim me të cilin e lë në fuqi aktvendimin kontestues si të ligjshëm. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 07.04.2023 ka administruar provat dhe atë: Aktvendimin 16911/02.11.2021, DUD-at R-61375/06.08.2021, R-61401/06.08.2021, R-61409/06.08.2021 me MV1 dhe MV6, Faturat nr:1347648, nr:1407166, nr:1424244, Librezat e veturave, Deklaratat eksportuese, Dëshmitë bankare të Kanadasë të dt:25.11.2020, 02.03.2021, 01.04.2021, Përgjigjen në padi të dt:23.02.2023, Ankesën e ushtruar në Doganën e Kosovës nr: 16911/03.09.2021, Proceset mbi Përcaktimin e Vlerës së Mallrave, Fotot e veturave 6 sosh, Shënimet e Doganës së Kosovës dt:06.08.2021 Vlerësim i dëmtimit të automjetit, Të dhënat nga katalogu schwacke, Aktvendimin

nr:2789/13.02.2023, 1590/27.01.2023 të dt:21.02.2023, si dhe DUD-at krahasues R-7475/05.04.2017, R-7476/05.04.2017, R-7477/05.04.2017 dhe R-7478/05.04.2017 së bashku me faturat.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar administrativ, deklarimeve në ankesë, shkresat e lëndës, aktvendimit kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit kryesor, gjykata ka gjetur se nuk ishte kontestues fakti se subjekti në procedurë Sh.K B.I, me seli në Prishtinë, ka paraqitur për zhdoganim DUD-at R-61375/06.08.2021, R-61401/06.08.2021, dhe R-61409/06.08.2021 të ZBD Prishtinë, sipas dokumentacionit përcjellës të mallit. Tutje nuk është kontestues as fakti tjetër që e paditura e ka kontestuar vlerën e deklaruar të mallit nga paditësi, e ku si rezultat i kësaj përmes procesit mbi përcaktimin e vlerës së mallrave, ka caktuar bazë të re doganore për këtë mall, duke u bazuar në metodën e 6 (gjashtë) të vlerësimit nga neni 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës nr.03/L-109, respektivisht në bazë të dhënave të disponueshme të Doganës së Kosovës, respektivisht katalogut përkatës schwacke.net dhe sipas vlerësimit të komisionit për zbritjen e shkallës së dëmit të automjeteve, me ç ‘rast edhe ju është bërë zbritja nga vlera e katalogut. Po ashtu nuk është kontestues as fakti se paditësi ka ushtruar ankesë në Doganën e Kosovës, e për të cilën ankesë e paditura me datë 02.11.2021 ka sjell aktvendimin nr.01.3.2.2/16911 i datës 02.11.2021, e ndaj të cilin aktvendim paditësi me padinë e datës 07.12.2021 ka iniciuar këtë kontest tregtar administrativ.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Dogana e Kosovës duke vepruar sipas ankesës së paditësit, e ka refuzuar kërkesën e subjektit në procedurë për rishqyrtimin e DUD-ave R-61375/06.08.2021, R-61401/06.08.2021, dhe R-

61409/06.08.2021 të ZBD Prishtinë, dhe ka lënë në fuqi të njëjtit. Me arsyetim se Sektori i Pranimit Qendror ka vepruar drejtë kur ka kontestuar vlerën e mallin lëndor pasi që vlera e mallit të deklaruar për zhdoganim nuk është vlerë reale e paguar për mallin me qëllim të importit në vendin tonë, për arsye se është deklaruar vlerë më e vogël se sa vlera reale e paguar apo që ka për tu paguar për mallin e shitur për eksport, përkatësisht për import në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të KDA-së, andaj, Dogana ka vendosur që vlera doganore të caktohet në bazë të metodës së 6 (gjashtë) të vlerësimit në vështrim të nenit 35 të KDA-së, respektivisht në bazë të dhënave me të cilat disponon Dogana e Kosovës të marra nga aplikacioni online Schwacke.net, dhe sipas vlerësimit të komisionit për zbritjen e shkallës së dëmit të automjeteve, me ç ‘rast edhe ju është bërë zbritja nga vlera e katalogut. Po ashtu, ka theksuar se Dogana e Kosovës për mallin lëndor kontestues disponon me të dhëna se vlera reale e këtij malli është ajo që është caktuar nga Sektori i Pranimit bazuar në të dhënat nga katalogu schwacke.net, metodë kjo e rregulluar me Shënimin e Brendshëm të aprovuar nga Drejtori Gjeneral i cili me qëllim të eliminimit të përdorimit të burimeve të ndryshme të informacionit jo zyrtar, dhe me qëllim të përcaktimit të drejtë të vlerës doganore për mallin automjete për transport të udhëtarëve dhe automjete për transport të mallit deri në 3.5 tonë, ka paraparë që kur vlera doganore nuk mund të përcaktohet sipas nenit 33 dhe 34 të KDA-së, bazuar në rekomandimet e grupit punues sipas Raportit 283/12.09.2017 të aprovuara nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm numër 482/22.09.2017, përcaktimi i vlerës doganore do të bëhet sipas nenit 35 bazuar në të dhënat e disponueshme të marra nga aplikacioni online schwacke.net që paraqet një të dhënë të besueshme dhe reale sa i përket vlerësimit të mallit lëndor. Ndërsa vlerësimi i dëmit të automjeteve është përcaktuar nga komisioni-ekipi për ekzaminim-ZBD Prishtina i cili ka vlerësuar dëmet me përqindjet si në vlerësimin e dëmit të automjeteve të përcaktuar me dt.06.08.2021.

Gjykata ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit administrativ brenda kufijve të kërkesëpadisë, në vështrim të nenit 44, parag. 1, të LKA-së, duke u kujdesur edhe sipas detyrës zyrtare për nulitetin e aktit administrativ, kjo sipas parag. 2, të këtij neni. Gjykata nuk ka mundur t’i merr për bazë pretendimet e paditësit të shprehura në padi dhe gjatë shqyrtimit kryesor

sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuara nga ana e organit të paditur, në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës dhe me dispozitat ligjore në fuqi.

Gjykata vlerëson si të pa-bazuar pretendimin e paditësit se e paditura ka vërtetuar në mënyrë të gabuar gjendjen faktike, ngase nuk i ka vlerësuar automjetet në mënyrë objektive duke qenë se të njëjtat kanë qenë të aksidentuara ose me defekte siç mund të shihet edhe nga fotot e dokumentacionit në shkresat e lëndës, kjo për faktin se gjykata konstaton se e paditura në aktvendimin e kontestuar drejtë ka vendosur kur ka konstatuar se në procedurën e administrimit të provave, dokumentacioni përcjellës i mallit është vlerësuar si provë e pamjaftueshme për të dëshmuar se vlera e deklaruar është vlerë reale e transaksionit, pasi që subjekti në procedurë me Deklaratat Unike Doganore nuk ka paraqitur transaksione bankare ndërkombëtare të vlefshme dhe të harmonizuara, andaj, në këtë kuptim nuk qëndron pretendimi i subjektit ankimore që e ka cekur në ankesë se lënda posedon gjithë dokumentacionin e nevojshëm për të aplikuar nenin 33 të KDA-së, andaj gjykata e pranon si të drejtë konstatimin faktik dhe qëndrimin juridik të bërë nga Dogana e Kosovës, këtu e paditura.

E paditura ka paraqitur në gjykatë dëshmitë nga Shteti i Kanadasë të dt: 25.11.2020, 02.03.2021, 01.04.2021, mirëpo gjykata të njëjtat nuk ka mundur ti vlerësoj si transaksione bankare ndërkombëtare për të dëshmuar vlerën doganore të mallrave të importuara e cila si vlerë e transaksionit, paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, siç kërkohet me dispozitat e nenit 33 par 1 të të KDA-s, ngase të njëjtat nuk kanë të dhëna mbi statusin e tyre, pra nëse të njëjtat janë të ekzekutuara ose jo, të dhëna mbi dërguesin e mjeteve, e as të dhëna referuar faturave, kontratave apo veturave përkatëse.

Ndërsa pretendimin e paditësit se vërtetimi jo i plotë i gjendjes faktike të veturave qëndron në faktin se nuk është marrë parasysh gjendja faktike e veturave, kjo gjykatë e vlerëson si të pa bazuara kjo për faktin se e paditura drejtë ka konstatuar në aktvendimin kontestues se Dogana e Kosovës nuk e mohon një fakt të tillë dhe për këtë arsye Komisioni për Vlerësimin e Dëmtimit të Automjeteve me datën 06.08.2021 sipas kërkesës së subjektit në

procedurë ka bërë vlerësimin e dëmit të tri automjeteve me shkallën e dëmtimit si për automjetin me nr. të shasisë WAYJCFM5CA130185 është zbritur shkalla e dëmtimit prej 30 % nga vlera e katalogut, WVWDM7AJ2DW004317 është zbritur shkalla e dëmtimit prej 35 % nga vlera e katalogut, dhe WVWDM7AJ0CW198070 është zbritur shkalla e dëmtimit prej 25 % nga vlera e katalogut. Prandaj, gjykata vlerëson se e paditura ka vepruar drejtë kur me vendimin kontestues ka konfirmuar rivlerësimin e mallit lëndor për Deklaratat Unike Doganore R-61375/06.08.2021, R-61401/06.08.2021, dhe R-61409/06.08.2021 të ZBD Prishtinë, duke aplikuar metodën e 6 të vlerësimit, neni 35 i Kodit Doganor dhe të Akcizave, respektivisht në bazë të dhënave të disponueshme të Doganës, katalogut schwacke.net dhe vlerësimit të Komisionit për zbritjen e shkallës së dëmit të automjeteve.

Në vijim pretendimin e paditësit se e paditura ka bërë shkeljen e parimeve të procedurës administrative përkatësisht parimin e ligjshmërisë, parimin e objektivitetit si dhe parimin e pa anësisë, gjykata e ka vlerësuar si të pa bazuar, ngase përveç të theksuar në padi si të tillë nuk e ka argumentuar me asnjë provë të vetme materiale këtë pretendim e që sipas nenit 7, Parag 1, dhe 3, i Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 parasheh se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla, ”* Nga këto dispozitat Gjykata konsideron se përdorimi i mjeteve dhe metodave të provuarit, nënkupton një detyrim për palët dhe respektimin e procedurave ligjore të përcaktuara me ligj. Tutje edhe sipas nenit 38, par 2, të LKA-se Gjykata vendos për gjendjen faktike përmes shqyrtimit verbal dhe vlerësimit të fakteve. Pala paditëse duhet të parashtroj faktet, në të cilat mbështetet kërkesa e saj. Esenca e parimit të shqyrtimit qëndron në atë se Gjykata do të merr parasysh vetëm ato fakte të cilat janë paraqitur dhe shtjelluar nga palët ndërgjyqëse, dhe tanimë është e qartë se barra kryesore për paraqitjen e fakteve dhe provave në një proces gjyqësor u takon palëve.

Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, në vështrim të nenit 43, paragrafi 1, të LKA-se. Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje

tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ, për arsye se as në këtë konflikt administrativ paditësi nuk ka qenë në gjendje që gjykatës t'ia dëshmoj provat për të vërtetuar se vlera e mallit lëndor është vlerë e vërtetë e transaksionit e paguar për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, siç parashihet me dispozitat e nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave nr. 03/L-109. Përkundrejt pretendimeve të paditësit në padi se për shkak të rivlerësimit paditësi ka paguar më tepër në emër të detyrimeve doganore mjetet në vlerë prej 1,679.17 Euro të cilat kërkon ti kthehet së bashku me kamatën e grumbulluar në shkallë prej 8% nga dt : 07.08.2021 e deri në kthimin e plotë, gjykata konstaton se dokumentacioni për mallin lëndor i paraqitur në këtë kontest tregtar - administrativ është i pamjaftueshëm për të konstatuar se vërtetë paditësi ka paraqit vlerën reale të mallit lëndor.

Gjykata thekson se në nenin 33 par.1 të KDAK-së është parashikuar se: *“Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, ndërsa në nenin 34 par.1 të KDAK-së parashihet që “Kur vlera doganore nuk mund të përcaktohet sipas nenit 33, ajo duhet të përcaktohet sipas renditjes kronologjike të nën-paragrafëve (a), (b), (c) dhe (d) të paragrafit 2, duke filluar nga nën-paragrafi i parë (metoda e dytë), që lejon përcaktimin e asaj vlere, me përjashtim të rasteve në të cilat radha e aplikimit të nën-paragrafëve (c) dhe (d) mund të kapërcehet me kërkesën e deklaruësit; Vetëm në rast kur vlera nuk mund të përcaktohet në bazë të një nën-paragrafi të caktuar, lejohet të aplikohen dispozitat e nën-paragrafit që vjen me radhë menjëherë pas tij”*. Nga këto dispozita ligjore, Gjykata konstaton se e paditura në rastin konkret, ka vepruar në mënyrë të drejtë kur ka rivlerësuar mallin e importuara nga paditësi, duke dhënë arsyetim të mjaftueshëm se përse vlerësimi i mallit nuk mund të bëhet me metodën e parë, siç parashihet me ligj, pasi që paditësi rezulton të ketë dorëzuar dokumentacionin jo të harmonizuar, e të kërkuar ligjërisht dhe kështu ka dështuar të provoj edhe vlerën e transaksionit për mallin e kontestuar, si dhe çmimin vërtetë të paguar, siç përcaktohet me nenin 33 par.1 të KDAK-së.

Vendimi për shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 64, të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 43, parag. 1, dhe nenit 46, parag. 2, të LKA-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.291/22 datë 07.04.2023

Zyrtari Ligjor
Albert HALITI

Gj y q t a r i,
Fisnik NULI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate.